Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Remzi Llumnica	**16.08.2023**	**13.09.2023**	**2023/0560**
Eksperti Teknik **Donijeta Sogojeva**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **25.08.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 1**0.08.2023, OE "\"ASFALT GROUP" SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0560**, kundër njoftimit për kontratë, **kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku nuk është rekomanduar për kontratë OE "\"ASFALT GROUP" SH.P.K."- Prishtinë**, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i Rruges X**" me nr. të prokurimit: "**632-23-397-5-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS**.Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: **punë**, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **4,357,000.00** €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0560 i dt:10.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Te dhenat mbi aktivitetin e prokurimit

1. Njoftimi per Kontrate: 17.04.2023
2. Data e hapjes se ofertave: 22.05.2023

3. Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 24.07.2023
4. Vendimi per refuzim te kerkeses per rishqyrtim: 07.08.2023

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- **Neni 1 i LPP-se**
- **Neni 7 i LPP-se**
- **Neni 56 i LPP-se**
- **Neni 59 i LPP-se**
- **Neni 60 i LPP-se**
- **Neni 69 i LPP-se**
- **Neni 72 i LPP-se**
- **Neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 Per Prokurim Publik**
- **Neni 26 i Rregullores Nr.001/2022 Per Prokurim Publik**
- **Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Per Prokurim Publik**
- **Neni 8 i Udhezuesit Nr.001/2023 Per Prokurim publik**
- **Neni 10 i Udhezuesit Nr.001/2023 Per Prokurim publik**

Pretendimet ankimore nga OE "ASFALT GROUP" SH.P.K."- Prishtinë drejtuar OSHP-se lidhur me arsyet e eliminimit dhe vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK-ja.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt.17.04.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 22.05.2023 ku kanë marr pjesë gjashtë operator ekonomik, ndërsa është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine, Kosovë me çmim prej: 4,270.543.21euro.

Neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Ju si Grup i Operatoreve Ekonomik keni prezantuar listën e kontratave te perfunduara:

- Lideri Asfalt Group shpk, ka prezantuar listën e kontratave të përfunduara ku vlera totale e tyre është 1,808,522.58 €, në kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 është kërkuar: *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 6,535.000,00€, gjatë tre viteve të fundit , në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.*

- Pra lideri, në këtë rast Asfalt Grup shpk, duhet të kishte kontrata të përfunduara në tri vitet e fundit në vlerë të minimum: (6,535,000.00 € x 60%) = 3,921,000.00 €, pra kjo ofertë nuk e plotëson këtë kusht që është fakt eliminues nga ky tender

Duke pasur parasysh se Grup i OE nuk i plotësoni kërkesat e sipërpërmendur të FDT-së, përkatësisht ka prezantuar liste për kontrata te realizuara dhe listë të pajisjeve te cilat nuk janë ne përputhje me listën për kontrata të realizuara dhe listën e pajisjeve sipas aneks 7 te FDT-ës, andaj kjo ofertë është refuzuar për shkak se dy listat e lartë cekura nuk janë plotësuar dhe dorëzuar ashtu siç kanë qenë të përcaktuara ne FDT (ka qenë obligimi plotësimi dhe dorëzimi i tyre me ofertë).

Për mungesa te dokumenteve tek stafi profesional qe janë cekur me lartë, nuk është kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-ës për shkak se mungojnë listat e lartcekura te cilat janë fakt eliminues për ofertën tuaj.

Fillimisht ju sqarojmë se është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit, sepse ne e plotësojmë kërkesën në lidhje me kontrata të natyrës së ngjashme në vlerën e kërkuar 6,535,000.00 €, e po ashtu edhe lideri e plotëson kërkesën prej 60 % të vlerës së kërkuar.

Me dosje të tenderit kemi bashkangjitur listën e kontratave të Liderit me 18 kontrata dhe dëshmi të përfundimit të tyre, e ku vlera e kontratave arrin 1,808,522.58 €, ashtu siç e ka cekur edhe autoriteti kontraktues për këtë listë.

Ne, përveç listës së lartpërmendur të punëve me autoritet publike, ju informojmë se me dosje të tenderit kemi bashkangjitur edhe dëshmitë e kryerjes së punëve me kompani private, por që për shkak të një lëshimi teknik nuk kemi bashkangjitur listën e kontratave me kompani private.

Kur analizohen dëshmitë e përfundimit të punëve me kompani private rezulton se lideri **ASFALT GROUP SH.P.K., e tejkalon vlerën e kontratave të kërkuara në dosje të tenderit, pra përmbushet kërkesa nga ana jonë që lideri të ketë 60 % të vlerës së kontratave.**

Në këtë rast është dashur të veprohet dhe të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ndërsa neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik e cek qartë si në vijim:

Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Pra, kur dorëzohen dëshmitë, siç janë referencat apo procesverbalet e pranimeve teknike apo kontrata dhe mungon lista e kontratave, atëherë mund të kërkohen sqarime shtesë, prandaj edhe AK-ja është dashur në këtë rast të kërkojë sqarime nga ne dhe të veprojë konform nenit 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik.

Ne e kemi bashkangjitur listën e kontratave me kompanitë private së bashku me kërkesën për rishqyrtim, mirëpo edhe me ankesë po e **Bashkangjesim listën e kontratave të përfunduara me kompani private.**

Po ashtu është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit ku ceket se kompania jonë ka ofruar listë të pajisjeve e cila nuk është në përputhje me listën e aneksit 7, sepse ne kemi ofruar listën e pajisjeve më të gjitha dëshmitë dhe të dhënat, prandaj kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme.

Ne kemi pas qasje në dokumentet e grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se ky grup është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim.

1. **<u>Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 3 është kërkuar</u> : Kamion (dumper) min 30 (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit).**

Në lidhje me këtë kërkesë grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar koka tërheqëse si në vijim:

1. Koke tërheqëse AB136CS Kazan AHR241
2. Koke tërheqëse AAR879 Kazan AA763DR
3. Koke tërheqëse AB974CM Kazan AHR247
4. Koke tërheqëse AB349JA Kazan ACR886

Dëshmitë e ofruara në lidhje me këtë kërkesë nuk janë sipas kërkesës, sepse janë ofruar Kamiona shlepera e të cilët nuk janë dumpera dhe kjo vërtetohet shumë lehtë kur krahasojmë fotot e Dumperave të cilat i kemi ofruar ne, me kokat tërheqëse dhe librezat të cilat i ka ofruar grupi i OE të rekomanduar për kontratë, e ku shihet që përveç tjerash pesha nuk është

Për Dumper, AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë duke e pyetur grupin e OE të rekomanduar për kontratë se kokat tërheqëse dhe gjysëmrimorkiot e ofruara nga grupi, a e kryejnë funksionin e njëjtë si të kamionit dumper?
Me këtë kërkesë për sqarime shtesë, vetë AK-ja faktikisht e ka pranuar që grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës, prandaj në këtë rast është dashur ta eliminojë këtë grup dhe ofertën e tyre ta shpall të papërgjegjshme.
Po ashtu edhe vetë OE i rekomanduar për kontratë në sqarimet e lartcekura e ka konfirmuar se nuk ka ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, ku për Dumper përgjigjen dhe sqarimin e ka dhënë si në vijim:

Makineritë damper të paraqitura nga ana jonë, i plotësojn të gjitha kriteret sipas kërkesës, që kanë peshën e njejtë, kazanin e kanë të njejtë si të damperëve si dhe gomat janë të mëd si të damperëve, të cilat munden të shihen edhe nga fotot e paraqitura.

Nga këto sqarime kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë e ka pranuar vetë se nuk ka ofruar dëshmi për Dumper por është munduar ti barazojë në aspektin funksional kokat tërheqëse dhe gjysëmrimorkiot e ofruara nga ky grup. Për më tepër shihen qartë kundërthëniet e grupit të OE të rekomanduar për kontratë sepse në njërën anë flasin për makineritë dumper e në anën tjetër e theksojnë se karakteristikat e këtyre makinerive i

Veprimi për të kërkuar sqarime nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë përbën favorizim të hapur, sepse mund të ketë kompani që nuk ka poseduar Dumper e që ka poseduar gjysëmrimorkio dhe koka tërheqëse dhe që nuk ka ofertu në këtë tender shkaku i kërkesave dhe makinerive specifike, prandaj trajtimi në këtë rast duhet të bëhet konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë e jo të lejohen ndryshime substanciale.
Me këto dëshmi ka qenë e qartë se ky grup i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesave të dosjes së tenderit, prandaj automatikisht është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të kërkohen sqarime.
Kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të analizohen në detaje dëshmitë dhe librezat e ofruara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë dhe të krahasohen me kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikat e makinerive të kërkuara.

Për të qenë një OE i përgjegjshëm duhet që tenderi në fjalë të jetë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe këtë e parasheh neni **59 paragrafi 4 i LPP-së**. Në këtë rast tenderi i grupit të OE "PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

2. **Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 8 është kërkuar:** Ngarkues min 32t -1 copë, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrëveshje me BIBA X shpk për Ngarkus Liebherr L564 (ne dud doganor 32.700.0000).

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka bashkangjit edhe dëshmi për një Liebherr L574 me peshë 25.500 ton, e i cili normalisht është më i madh me peshë se sa Liebherr L564
Këtu shihet kundërthënia e dëshmisë së ngarkuesit Liebherr L564 me peshë 32,700.0000 me gjendjen reale. Prandaj kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të analizohen saktë dhe të krahasohen dëshmitë dhe faktet se cili ngarkues ka peshë më të madhe dhe qartë do të vërehet kundërthënia e dëshmive të ofruara të grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

Kur analizohen dhe verifikohen në internet/katalogë vërehet se Liebherr L564 ka me peshë 22-25 ton por **nuk** ka 32 tonë. Poashtu është e çuditshme pesha e shënuar 32.700.0000, pra me katër zero pas pikës.

Sa i përket sqarimeve të ofruara për Ngarkues min 32t -1 copë, grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarimin si në vijim:

Pika 8, ngarkusja mbi 32 ton është e marrur me qera nga kompania "Biba X" në Shqipëri kontratë është në pjesën e 29 të dosjes së tenderit, tek faqja 290 është kontrata e qeras për makineri, ndërsa dudi ose dokumenti për këtë makineri është në faqen 311.

Duke pasur parasysh sqarimet e lartpërmendura **kërkojmë** nga ekspertët e OSHP-së që të verifikohen të dhënat e kësaj pajisje në internet, e ku mund të vërtetohet pretendimi jonë ankimor.

3. Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 12 është kërkuar: Lugë hidraulike Ripper min. 2.5t maksimum 3t, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë

Këto dy makineri që i ka prezantuar grupi i OE të rekomanduar për kontratë **NUK** janë lug hidraulike Ripper 2.5-3 ton.
Përveç se nuk janë lugë hidraulike, të njëjtat pajisje të prezantuar nga ky grup janë edhe me pesha më të mëdha se sa kërkesa siç është kërkuar 2.5-3 tonë.
Këto pajisje mund të jenë të ndërlidhura me pikën 8 të listës së kërkuar të pajisjeve ku është kërkuar Ngarkues min 32t , mirëpo edhe me këtë kërkesë nuk përputhen dëshmitë e peshës së kërkuar prej 32 tonë, sepse njëra pajisje ka peshë 9 tonë, ndërsa tjetra 24.420 tonë sipas DUD doganor.
Edhe për këtë pajisje janë kërkuar sqarime shtesë, ndërsa me sqarime grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarimet si në vijim:

Për pikën e 12 janë prezentuar dy luga ngarkuse me lopat, ndërsa është kërkuar Ripper me peshë min 2.5t dhe maksimum 3t.

Ngarkuset me lopat të cilat i kemi paraqitur, lopatën e kanë të llojit Ripper mirëpo, meqenëse nuk kanë dud ose dokument ndaras nga ngarkuset, atëherë është dashtë që të futen së bashku me makinerin ngarkuse, por që lloji i lopatës është e njëjta me atë që është kërkuar.

Edhe nga sqarimi i dhënë nga vetë grupi i OE të rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se dëshmitë e ofruar nga ky grup nuk kanë janë lugë hidraulike Ripper.

Për më tepër grupi i OE të rekomanduar për kontratë me sqarime, e ka cekur **ngarkuesit me lopatë,** por ju sqarojmë se Luga hidraulike Ripper nuk është për ngarkim por është lugë hidraulike për **nxjerrjen e gurëve apo materialeve të forta**. Pra edhe nga sqarimi i vetë grupit të OE të rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se dëshmitë e ofruara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk janë në harmoni kërkesat e dosjes së tenderit.
Është shumë e qartë se edhe në aspektin funksional **nxjerrja e gurëve dhe materialeve të forta DALLON** me **ngarkimin** e këtyre materialeve.

Shih Foto të Lugës Ripper siç është kërkuar dhe siç është prezantuar nga ne.

Kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të krahasohen dëshmitë e grupit të OE të rekomanduar për kontratë me kërkesën e dosjes së tenderit, e ku mund të kuptohet lehtë dhe qartë dallimi ndërmjet dëshmive të ofruara dhe kërkesës së dosjes së tenderit.

të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi si në vijim:
Kamion me targa AA 247 ZV
Kamion me targa AB 453 CJ
Kamion me targa AB 928 CO
Kamion me targa AA 921 CO
Këta kamiona janë në pronësi të kompanisë ALESIO 2014 SHPK, mirëpo për këta kamiona nuk ka asnjë marrëveshje ndërmjet PEVLAKU SHPK me Alesio 2014 SHPK se i ka marr me qira këto pajisje. Prandaj këto dëshmi nuk kanë asnjë vlerë në këtë projekt dhe ligjërisht nuk mund të merren parasysh.
Me sqarime shtesë grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një kontrate qiraje të lidhur ndërmjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhënës dhe PEVLAKU SHPK si qiramarrës por kontrata ka të bëjë për projektin "**Ndërtimi i rrugës dalja për pejë-pjesë e qarkores së qytetit"-KK Gjakovë.**
Thjesht kjo kontratë për qira është e pavlefshme dhe nuk mund të merret parasysh sepse është e lidhur për një projekt tjetër. **Kjo kontratë nuk ka vlerë për asnjë nga pajisjet që janë të cekuar në këtë kontratë sepse nuk ka të bëjë me këtë projekt dhe nuk konsiderohet e vlefshme.**
Kontrata për pajisjet e lartcekura vlen vetëm për një projekt dhe atë është i cekur projekti për të cilin janë marr vesh, pra për projektin **Ndërtimi i rrugës dalja për pejë-pjesë e qarkores së qytetit"-KK Gjakovë.**
Kjo kontratë është specifike dhe duhet të trajtohet njëjtë nga të gjitha palët dhe nuk mund të përdoret kontrata specifike për projekte të përgjithshme pa qenë specifikuar.

5.Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 23 është kërkuar: Kamion spërkatës për bitum dhe emulsion-1.
Me sqarim shtesë në lidhje me këtë pajisje, grupi i OE të rekomanduar për kontratë është përgjigjur si në vijim:

Për pikën 23, Kamion spërkatëse për bitum dhe emuluzion

Edhe kjo makineri është makineri e marrë me kontratë qeraje nga Shqipërija, nga kompania "Alesio -2014" shpk e cila gjendet në pjesën e 29 të dosjes së tenderit, tek faqja 202, ndërsa dokumenti i mjetiti në fjalë është në faqen 268, ku është e paraqitura fatura e blerjes nr.18 me të dhënat dhe dokumentet tjera të mjetit.

Nga analizimi i dokumentacionit të këtij grupi të OE të rekomanduar për kontratë dhe nga sqarimi i dhënë në lidhje me këtë pajisje, ju sqarojmë si në vijim:
Në pjesën nr.29 të dosjes së tenderit të dorëzuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë është një kontratë qiraje ndërmjet Qiradhënësit ALESIO 2014 SHPK dhe qiramarrësit PEVLAKU SHPK, ku pajisjet të cilat merren dhe jepen me qira në këtë marrëveshje janë në listuara si në vijim:

Duke qenë se:

a) Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjesë në *tenderin* " Ndërtimi i Rrugës X" me Autoritet Kontraktor *Komuna e Gjakovës* dhe ajo është e interesuar të marrë me qera njësitet e nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Përshkrimi	Te Dhenat
Kamionete dubelkabine	Targa : AA083VA Leje qarkullimi : TRDA3992618 Shasia : ZCFC3591005478242
Kamionete dubelkabine	Targa : AB230AG Leje qarkullimi : TRDA1718820 Shasia : WF0EXXTTGEG023928
Autopompe betoni	Targa : AA803TH Leje qarkullimi : TRDA0739918 Shasia : ZCNH884456P[illegible]

Fq. 1

Nga kjo listë shihet qartë se **NUK** ka dhënie/marrje me qira për pajisjen **Kamion spërkatës për bitum dhe emulsion.** Pra kjo pajisje nuk është pjesë e kontratës në fjalë.
Sa i përket përgjigjes me sqarime, ku është cekur fatura e blerjes me Nr.18 na faqen 268, ju sqarojmë se në këtë faturë figuron se e ka blerë ALESIO 2014 SHPK një kamion të përdorur me cisternë bitumi, mirëpo kjo faturë nuk ka të bëjë fare me kontratën për qira të pajisjeve dhe kjo pajisje e cekur në faturë nuk është pjesë e kontratës, të cilës i është referuar edhe vetë grupi i OE të rekomanduar për kontratë.
Thjesht kjo faturë është një dokument i parëndësishëm dhe i pavlerë për këtë projekt sepse nuk është i përfshirë në kontratë për qira për pajisje. Për më tepër fatura është goxha e padukshme dhe e paqartë.
Me sqarime shtesë grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një kontrate qiraje të lidhur ndërmjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhënës dhe PEVLAKU SHPK si qiramarrës, e ku në listën e kësaj kontrate gjendet Kamion spërkatës për bitum Targa AA 704 PY.

Kamion sperkatese per bitumen dhe emulzion ne rruge	Targa : AA704PY Leje qarkullimi : TRDA1045717 Shasia : YB1E5A2A1NB490531

Me këtë ngjyrë e ka hijezuar vetë grupi i OE të rekomanduar për kontratë duke aluduar se kjo pajisje është marr me qira, mirëpo ju sqarojmë se kjo pajisje është pjesë e kontratës së qirasë të dt.18.05.2023, e që kjo kontratë nuk ka të bëjë me projektin që ka ofertuar ky grup

Duke qenë se:

a) Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjesë në *tenderin " Ndertimi i rruges dalja per Peje - Pjese e qarkores se qytetit"* me Autoritet Kontraktor *Komuna e Gjakoves* dhe ajo është e interesuar të marrë me qera mjetet e nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Pra është fjalë për projektin "**Ndërtimi i rrugës dalja për pejë-pjesë e qarkores së qytetit"-KK Gjakovë.**
Thjesht kjo kontratë për qira është e pavlefshme dhe nuk mund të merret parasysh sepse është e lidhur për një projekt tjetër. **Kjo kontratë nuk ka vlerë për asnjë nga pajisjet që janë të cekuar në këtë kontratë sepse nuk ka të bëjë me këtë projekt dhe nuk konsiderohet e vlefshme.**
Sa për krahasim, ju sqarojmë se një kontratë tjetër e lidhur po nga këto dy palë, dhe e dorëzuar me dosje të tenderit shkruan qartë dhe specifikohet se është për këtë projekt e që gjendet në faqe 202 në pjesën 29 të dosjes së dorëzuar dhe shkruan si në vijim:
Duke qenë se:

a) Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjesë në *tenderin* " Ndërtimi i Rrugës X" me Autoritet Kontraktor *Komuna e Gjakoves* dhe ajo është e interesuar të marrë me qera mjetet e nevojshme për kryerjen e punimeve, ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme:

Nga këto sqarime, kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për pajisjen Kamion spërkatës për bitum dhe emulsion.
Nga dëshmitë që u cekën më lartë kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata që nuk janë lidhur për këtë projekt dhe që nuk kanë asnjë vlerë për këtë projekt, mirëpo ka edhe kontratë që është e lidhur për këtë projekt, prandaj nga ky krahasim kuptohen dëshmitë dhe kontrata që nuk janë për këtë projekt.

6.Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 23 është kërkuar Buldozher min 25t, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për këtë pajisje.

7.Në nenin 9.1&9.2 të DT-së është kërkuar "Operatori Ekonomik duhet te ketë Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit te cilësisë, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se ka në kuadër të grupit Lead Auditor sipas ISO 9001:2015, por ka ofruar dëshmi për auditor të brendshëm. Si auditor të brendshëm ka ofruar dëshmi për z. Redi Binaj.
Pra dëshmia e ofruar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk është sipas kërkesës së FDT-së, prandaj edhe për këtë arsye është dashur të eliminohet grupi i OE PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine.

8.Në nenin 9.1&9.2 të DT-së është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet te ketë një Lead auditor udhëheqës sipas kërkesës së ISO 45001-2018 Sistemi i Menaxhimit te

Pra dëshmia e ofruar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk është sipas kërkesës, prandaj edhe për këtë arsye është dashur të eliminohet grupi i OE PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine.
Kërkojmë nga ekspertët shqyrtues që të analizohen dëshmitë e ofruara të grupit të OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën për Lead auditor.

9.Operatori Ekonomik duhet te ketë një ekspert të certifikuar nga AME (agjensioni për menaxhimin e emergjencave) për mbrojtje nga zjarri, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi **një certifikatë te lëshuar nga autoriteti shqiptar për z. Dritan Lani, e jo nga AME ashtu siç është kërkuar.** Prandaj kjo certifikatë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

10.Mungon deklarata e anëtarëve të konsorciumit ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

Duke pasur parasysh të gjitha mangësitë dhe të metat e ofertës së grupit të OE të rekomanduar për kontratë rezulton se oferta e tyre është e papërgjegjshme, ndërsa se kur duhet të konsiderohet oferta e përgjegjshme e cek qartë edhe neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku përcaktohet si në vijim:

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme në aspektin administrativ dhe teknik.
Dëshmitë e ofruara nga grup dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit.

Rekomandimi për kontratë nuk është bërë në harmoni edhe me nenin 56 të LPP-së sepse nuk janë marr për bazë kriteret e përzgjedhjes ashtu siç parashihet në këtë dispozitë.
Ligjërisht grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka mundësi të shpërblehet për kontratë pasi që edhe neni 25 i Rregullorës Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e parasheh qartë se kur mund të konsiderohet i kualifikuar një Operator ekonomik.

Neni 25.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe
b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues

Neni 25.2 Kërkesat e pranueshmërisë, gjithnjë duhet të përmbushen nga OE.

25.5 Kriteret e përzgjedhjes:
a. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës
b. nuk mund të kenë peshë të caktuara;
c. **ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon**

Pra në bazë të dëshmive të cekura më lartë rezulton qartë se grupi i OE "PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine nuk i ka përmbush kërkesat minimale për kualifikim, prandaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.
Pra kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa të vlerësimit **Kalon/Nuk kalon**, ndërsa në këtë rast këto kërkesa nuk janë përmbushur nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë dhe oferta e këtij grupi nuk është dashur të kalojë më tutje.
Këtë fakt e qartëson edhe Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurim Publik ku në nenin 8.5 përcakton qartë:

8.5 Kriteret e përzgjedhjes:
i. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës
ii. nuk mund të kenë peshë të caktuara;
iii. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon

Niëra ose tietra

Kërkesat janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë,

ose

Kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë

Në rastin konkret kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderi i grupit të OE të rekomanduar për kontratë është dashur të refuzohet menjëherë.

Më poshtë janë të cekura edhe arsyet e eliminimit të OE tjerë e që realisht këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona.

OE Lika Trade Shpk është i papërgjegjshëm dhe pajtohem me arsyen e eliminimit ku është është cekur si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar listën e pajisjeve sipas formës ne aneksin 7 te FDT-es, ku:

- Pika 12 është kërkuar Lugë hidraulike Ripper min. 2.5t maksimum 3t, ndërsa ju keni prezantuar bager Hanomag, tipi: 55D, pajisje kjo qe nuk plotëson kërkesën minimale te listës se pajisjeve përkatësisht te pikës 12 te saj.
- Pika 18 keni prezantuar finisherin Vogel, tipi: Super S 1800-3, i cili nuk ka peshën sipas kërkesës se FDT-ës, ndërsa finisheri Vogel, tipi Super 1900 ka peshë nën 25t, këto dy pajisje nuk i plotësojnë kërkesat minimale qe ishin ne FDT, sepse ne FDT është kërkuar qe Finisheri për asfaltimin e rrugëve te kete peshe min 25t.
- Në pikat 20, 21, 22, te listës se pajisjeve cilindrat e prezantuar nga ju nuk janë me rrota, ne FDT është kërkuar qe te prezantoni cilindër me rrota të kombinuara (gome dhe hekur), min 2.5t, cilindër me rrota të kombinuara (goma dhe hekur), min 6.5t, cilindër me rrota hekuri me vibrim, min 8.0t

Nga kontrollimi i me tejshëm e dokumenteve te dorëzuara tek pjesa e Stafit janë gjetur këto mangësi:

- Menaxheri i projektit z. Sadri Kukaj, i mungon certifikata e për siguri dhe shëndet në punë dhe certifikata për menaxhimin e projekteve
- Udhëheqësit të punishtes, z. Adnan Spahija i mungon certifikata për menaxhim dhe organizim të kantierit
- Të certifikuar 29 punëtor me certifikatë SSHP, janë kërkuar 50 punëtor të certifikuar, nuk e përmbush kriteret e FDT-së.

OE Victory Com&Eskavatori SHPK&Marisa SHPK është i papërgjegjshëm dhe pajtohem me arsyen e eliminimit ku është është cekur si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Ju si Grup i Operatoreve Ekonomik keni prezantuar :

Lista e kontratave të realizuara jo sipas formës së listës në Anksin 7 të FDT-ës, ku shkruan: Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë, pra ky aneks nuk është plotësuar dhe dorëzuar.

Mungon lista e pajisjeve sipas aneks 7 të FDT-ës ku shkruan Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë

Mungon lista e stafit profesional

- Menaxherëve të projektit ing. Izabela Muca dhe ing. Beq Hadergjonaj, ju mungon certifikata për siguri dhe shëndet si dhe certifikata për menaxhimin e projekteve
- Udhëheqësi i punishtes z. Besnik Zogu, i mungon certifikata për menaxhim dhe organizim të kantierit.
- Inxhinierit të Elektrikes z. Kristë Duzhmani i mungon CV-ja dhe Kontrata e punës.

Duke pasur parasysh se Grup i OE nuk i plotësoni kërkesat e sipërpërmendur të FDT-së, përkatësisht ka prezantuar liste për kontrata te realizuara dhe listë të pajisjeve te cilat nuk janë ne përputhje me listën për kontrata të realizuara dhe listën e pajisjeve sipas aneks 7 te FDT-ës, andaj kjo ofertë është refuzuar për shkak se dy listat e lartë cekura nuk janë plotësuar dhe dorëzuar ashtu siç kanë qenë të përcaktuara ne FDT (ka qenë obligimi plotësimi dhe dorëzimi i tyre me ofertë).

Ne me dt.07.08.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku AK-ja është arsyetuar se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete për një refuzim të tillë.

Sa i përket pretendimit tonë se ne kemi ofruar me kërkesë për rishqyrtim edhe listën e kontratave me kompani private, ndërsa me dosje kemi pasur të bashkangjitur të gjitha dëshmitë tjera për kryerje të punëve, autoriteti kontraktues nuk është lëshuar fare në këtë pretendim por i është referuar vetëm listës së kontratave me autoritetet publike dhe njëkohësisht nenin 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik e ka interpretuar pjesërisht dhe në mënyrë diskriminuese në raport me kompaninë tonë sepse i është referuar vetëm pjesës ku shkruan që lista e kontratave të realizuara nuk përmbush kërkesat minimale-refuzo tenderin.

AK-ja në këtë rast nuk e ka marr për bazë pjesën tjetër të nenit 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik ku ceket qartë:

Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që dëshmitë prezantuar nga ne të mos anashkalohen

punëve me kompani private dhe të kërkohen sqarime për listën e cila nuk eshte basnkengjit për shkak të një lëshimi teknik.
Sa i përket pretendimit tonë se dëshmitë e ofruara në lidhje me Dumperat nuk janë sipas kërkesës, sepse janë ofruar Kamiona shlepera e të cilët nuk janë dumpera, autoriteti kontraktues është përgjigjur në këtë pretendim duke konstatuar se ky pretendim është i pabazuar sepse sqarimet e dhëna nga OE fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për AK.
Edhe me këtë përgjigje, AK-ja nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimit tonë ankimor, prandaj në mungesë të argumenteve pohon se sqarimet janë bindëse.
Ofertat nuk shqyrtohen dhe nuk vlerësohen prej këndit se a e bindin ndonjë zyrtar apo komision por ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj fjala janë bindëse tregon për mungesën e argumentimit të vendimit të tyre dhe subjektivizmin e AK-së në raport me grupin e OE të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket pretendimit tonë në lidhje me Ngarkuesin min 32t -1 copë, autoriteti kontraktues është përgjigjur se e merr të mirëqenë ku në DUD doganor shënon se është 32 tonë, mirëpo AK-ja në këtë rast nuk ka shpreh fare interesim të trajtojë pretendimin tonë ankimor ku kemi kërkuar që të verifikohet saktë pesha e këtij ngarkuesi, prandaj edhe ky veprim i AK-së që të mos verifikojë pretendimin tonë ankimor tregon për njëanshmëri të plotë në drejtim të OE të rekomanduar për kontratë.
Edhe sa i përket pretendimit tonë ankimor se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës për Lugë hidraulike Ripper min. 2.5t maksimum 3t, autoriteti kontraktues është përgjigjur në këtë pretendim duke konstatuar se ky pretendim është i pabazuar sepse sqarimet e dhëna nga OE fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për AK.
Edhe në lidhje me këtë pretendim, AK-ja nuk ka mundur të argumentojë të kundërtën prandaj ka thënë se dëshmitë e ofruar janë bindëse. Pra autoriteti kontraktues bënë konstatime dhe vlerësime në bazë të bindjes së lirë, e që këto veprime janë kundërligjore.

Sa i përket pretendimit tonë të katërt dhe të pestë, AK-ja e ka cekur se OE Pevlaku ka ofruar marrëveshje me Alesio për marrje me qira të autobetonierkave-mikserëve dhe për kamion spërkatës për bitum dhe emulzion, mirëpo në këto përgjigje nuk është lëshuar në detaje për të qartësuar pretendimin tonë ankimor se marrëveshjet e tilla janë për projekte të tjera e jo për këtë projekt dhe se marrëveshjet janë jo valide. Prandaj në pamundësi për ti kundërshtuar pretendimet tona më fakte, AK-ja e ka zgjedhur të përgjigjet vetëm shkurtimisht dhe duke mbrojtur vendimin e tyre fillestar për të rekomanduar grupin e OE, e i cili grup realisht është i papërgjegjshëm.

Në lidhje me pretendimi tonë ankimor se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për pajisjen Buldozher min 25t, autoriteti kontraktues është përgjigjur shkurt duke thënë se është prezantuar dëshmi, mirëpo nuk ka qartësuar se ku gjendet kjo dëshmi dhe nga cili anëtar i konsorciumit është prezantuar.
Edhe në lidhje me këtë pretendim AK-ja nuk ka mundur të argumentojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se ka në kuadër të grupit Lead Auditor sipas ISO 9001:2015, Lead Auditor

AK-ja ka mundur të ofrojë dëshmi për ndonjë certifikim por nuk ka ofruar dëshmi për certifikime sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj certifikimet tjera janë të pavlefshme në këtë rast.
Edhe në lidhje me këto pretendime AK-ja hapur ka mbështetur njoftimin mbi vendimin e AK-së (B58) dhe nuk është lëkundur nga qëndrimet e tyre, pavarësisht se nuk ka mundur të argumentojë veprimet dhe konstatimet e tyre.

Edhe sa i përket pretendimit tonë ankimor se mungon deklarata e anëtarëve të konsorciumit ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit, AK-ja vetëm është përgjigjur se ekziston një deklaratë e tillë pa argumentuar këtë konstatim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm, sipas neni 60 paragrafi 1.2 i LPP-së.**

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së në mënyrë të drejtë, pasi që ka kërkuar sqarime nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë për dëshmi të cilat kanë qenë të qarta (në kundërshtim me kërkesat e FDT-së) e që realisht nuk ka pasur arsye ligjore të kërkohen sqarime. Po ashtu nenin 72 të LPP-së e ka përdor në mënyrë të njëanshme duke kërkuar sqarime vetëm nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë edhe pse nuk ka pas arsye ligjore, ndërsa nuk ka kërkuar sqarime nga ne edhe pse ka pas arsye dhe mbështetje ligjore.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", kurse grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pra është vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"ASFALT GROUP SH.P.K. &CURËRARDHI SH.P.K&Benita Company&DREONI SH.P.K. Gremnik**

RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 20,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Përgjigje dhe dokumentacioni perciellës sa i përket kërkeses për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit nga OE "ASFALT GROUP" SH.P.K."- Prishtinë - Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK-ja.

1.Vendimi i AK mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK i dates 03.08.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **''ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve ekonomik **"ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, **i publikuar me datë: 24.07.2023;**

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Arsyetim

Me dt.28.07.2023, Grupi Operatorëve ekonomik **"ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K;; Benita Company; Dreoni SH.P.K.,** ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.08.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj në lidhje me eleminimin e ofertës tuaj është i pabazuar, sepse lista e kontratave e parqitur nga ju nuk e përmbush kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë(lideri duhet të ketë 60% të vlerës së qarkullimit).

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Pretendimi juaj i parë lidhur me damperët, gjithashtu është i pabazuar sepse me sqarimet shtesë të ofruara nga Operatori ekonomik fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi juaj i dytë lidhur me ngarkuesit, është i pa bazuar sepse në dudin doganor shënon se është 32 ton dhe këtë Autoriteti kontraktues e merr si të mirëqenë.

Pretendimi juaj i tretë lidhur me lugët hidraulike, gjithashtu është i pabazuar sepse me sqarimet shtesë të kofruara nga Operatori ekonomik fitues kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi juaj i katërt nuk qëndron pasi që koncesnionari PEVLAKU shpk, ka prezantuar marrëveshje me Alesio shpk për marrje me qera të autobetonierkave – mikserëve.

Pretendimi juaj i pestë, nuk qëndron pasi që koncesnionari PEVLAKU shpk, ka prezantuar marrëveshje me Alesio shpk për marrje me qera të kamionit spërkatës për bitum dhe emulzion.

Pretendimi juaj i gjashtë, nuk qëndron pasi që është prezantuar dëshmi për buldozer min 25t.

Pretendimi juaj i shtatë, i tetë dhe i nëntë nuk qëndron pasi që GOE ka dorëzuar certifikimet në përputhje me kërkesën në pikën 9.1&9.2 të DT-ës.

Pretnedimi i juja i dhjetë për deklaraten e anëtarëve të koncersiumit nuk qëndron pasi që një deklaratë e koncersiumit të GOE është dorëzuar bashkë me ofertë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseëankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

2. Kerkese drejtuar OE i rekomanduar per kontrate - Leter standarde e kerkeses per informata mbi tenderet nga AK i dates 18.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

Gjakovë: 18.07.2023

KOMUNA E GJAKOVËS, Rr "Nënë Tereza" 50000 GJAKOVË

Për: Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I. Rr. Tringe Smajli 16/7. 10000, Prishtine

Nr. i prokurimit:	**632-23-397-5-1-1**
Nr i brendshëm	**632-23-003-5-1-1**

Titulli: Ndërtimi i Rrugës X

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"

Pas vlerësimit dhe analizimit te dokumenteve qe ju keni dorëzuar kemi vërejtur këto mangësi:

Sqarim:

